

Outloud Podcast

Podcast për Personat e Zhdukur

Audio podcast - Jasmina Živković-Jovanović.

Unë jam Jasmina Živković-Jovanović, vajza e të kidnapuarit Paun Živković, i cili u mor më 28 shtator 1999, në një ndërtesë shkolle në Ferizaj, teksa ishte i shoqëruar nga trupat e KFOR-it. Ka qenë drejtor i Shkollës së Mesme Teknike në Ferizaj dhe që nga ajo ditë nuk kemi asnjë informacion se çfarë ka ndodhur me të.

Jovanović është mbiemri im prej që jam martuar. Jam lindur më 26 tetor 1977 në Prishtinë. Dikur kam jetuar në Ferizaj, ku kam mbaruar shkollën fillore dhe të mesme. Pra, Ferizaj është vendlindja ime. Te dy prindërit e mi janë lindur në Štrpce. Pas përfundimit të shkollës fillore dhe të mesme, u regjistrova në Fakultetin Juridik në Prishtinë dhe deri në vitin e tretë të studimeve isha me program të rregullt dhe orar të plotë dhe lirshëm mund të them, ishin studime të mira – derisa filluan bombardimet dhe lufta ndërpreu shkollimin tim. Për ta thënë më thjesht, jeta filloi të rrjedhë në një drejtim tjetër prej atij çasti.

Dua ta përmend se jam martuar këtu në vitin 2003, në komunën e Štrpce, në Kosovë. Prej Ferizaj më është dashur të largohem, pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Kumanovës, sepse thjesht nuk ishte më e sigurt për ne të qëndronim në shtëpinë tonë. U martova, u lindi në Mitrovicë, vazhdova të jetoj këtu. Shkurt, nuk jam larguar as edhe një ditë nga Kosova.

...prindërit e mi, për shkak të angazhimeve të tyre në punë, i kishin mundësitë që të shpërngulen nga Štrpce në Ferizaj, ku punonin si mësues. Nëna ime ishte mësuese në shkollë fillore, ndërsa babai, profesor i biologjisë dhe më vonë u bë drejtor i Shkollës së Mesme Teknike në Ferizaj. Në fund u bë drejtor i Shkollës Teknike të Ferizajt.

Kemi jetuar një jetë mesatare për një familje katër-anëtarëshe, në fakt, më vonë u bëmë pesë, sepse unë kam një motër që është 11 vjet më e vogël se unë. Dhe, thjesht, kemi jetuar ashtu siç na diktuan kushtet – llojin e jetesës në Kosovë siç e bënë shumica e familjeve. Dhe nganjëherë, na duhej t'i neglizhionim dëshirat dhe pritshmëritë tona, duke iu përshtatur situatave ashtu siç na duhej, por mund të them që jeta rrodhi normalisht, disi.

Pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Kumanovës më 10 qershor... Meqë ishim e vetmja familje serbe në rrugën ku jetonim, ndienim pasiguri, kështu që nuk mundëm të vazhdonim të jetonim më aty. Babai vendosi që ishte më mirë për ne që të ktheheshim në Štrpce.

Kjo ndodhi më 21 prill, kur erdhëm këtu për herë të parë, në komunën e Štrpce, që të mund të jetonim në terren më të sigurt, në kuptimin që serbët përbënin popullsinë shumicë. U larguam nga shtëpia me nxitim, duke mos marrë asgjë, përpos gjërat që i kishim në trup. Prisnim se do të

kishim mundësi të ktheheshim kur të donim, sepse pse të mos kishim mundësi të ktheheshim? Kështu që, morëm vetëm disa dokumente me vete. Gjërat tjera mbetën në shtëpi.

Siç e përmenda edhe më parë, babai ishte drejtor i Shkollës së Mesme Teknike. Ai kishte përgjegjësi të caktuar ndaj punëtorëve dhe nxënësve të tij, të cilëve gjithashtu iu desh të largoheshin nga qyteti i Ferizajt. Në atë kohë, kur serbët, të gjithë serbët u detyruan ta braktisnin Ferizajn, për shkaqe sigurie, besoj, rreth 14 qershorit. Dhe të gjithë ikën për në Serbi.

Mirëpo, meqenëse iu duhej të regjistroheshin në shkollë dhe për ta vazhduar shkollimin, nxënësit që vijonin shkollën teknike, vazhdimisht e kontaktonin babanë tim, si dhe kolegët e tjerë të tij që ndodheshin aty, në Štrpce. Në mesin e tyre dua të përmend axhën Marko Stojanović, i cili ishte drejtor i shkollës së parë fillore. Ata përpiqeshin t'i merrnin dokumentet në mënyrë që të kishin dëshmi se kanë ndjekur shkollë në një nivel të caktuar, në mënyrë që të mund ta vazhdonin shkollimin në vendin ku kishin mbërritur; e njëjta gjë vlente edhe për nxënësit dhe mësuesit. Axha Marko, Milan dhe babai im largoheshin rregullisht nga këtu për të kërkuar leje nga KFOR-i që t'i përcjellë në Ferizaj dhe për në këto shkolla që t'i merrnin ato dokumente.

Ishte 28 shtator i vitit 1999, kur e morën, si ta thuash, lejen që dy vetura të KFOR-it t'i përcillnin deri në shkollë, që t'i marrin dokumentet që gjendeshin atje, nëse nuk ishin të djegurat tashmë. Këto ishin certifikatat e shkollës, dokumentet dhe gjëra të tjera. Gjithçka ndodhi rreth orës tetë të mëngjesit — pa njoftim paraprak një ditë më parë ose disa ditë më parë — që ata do t'i merrnin pikërisht atë ditë. Më 28 shtator, rreth orës tetë të mëngjesit, erdhi Milan Nikolčević dhe i tha babait: "Paun, sot do të na çojnë në Ferizaj". Dhe KFOR-i polak caktoi dy automjete si përcjellëse. Ishin dy vetura të KFOR-it polak dhe gjashtë serbë, të cilët i morën atë ditë në Ferizaj. Tek rreth orës 07:00 të mbrëmjes janë kthyer dy vetura në Štrpce, duke na thënë se Paun dhe Marko janë zhdukur dhe se janë në kërkim të tyre. Ata i mbledhën gjërat e tyre dhe u nisën për në bazën e tyre, në Brezovicë.

Së pari, nuk e dinim se çfarë nënkuptonte "i zhdukur". Si u zhdukën nëse kishin përcjellje me vete? Në shkollë, në mes të qytetit, në mes të ditës. Si mund të zhduken dy persona? Kur e morëm veten dhe u bashkuam, shkuam tek baza polake në Brezovicë, duke u përpjekur t'i kontaktonim ushtarët që i përcollën ata atë ditë. Megjithatë, nuk na lejuan të hynim. Edhe sot e kësaj dite nuk i dimë ende emrat e atyre që shoqëruan babin dhe axhën Marko dhe si u zhdukën në të vërtetë. Asnjëherë nuk kanë dashur të na japin emra dhe as të (mundësojnë) një bisedë me ata njerëz. Prej asaj dite, unë, familja ime dhe familja e axhës Marko, gruaja dhe djemtë e tij, po përpiqemi ta zbulojmë të vërtetën për atë që ndodhi atë ditë. Ende nuk e dimë.

Ne krijuam kontakte me të gjitha institucionet ekzistuese të mundshme që atëherë ishin përgjegjëse për stabilitetin dhe paqen në Kosovë. Fatkeqësisht, megjithatë, ata sollën rezultate të kundërta me ato për të cilën kishin ardhur. Dhe ne ende nuk e dimë të vërtetën. Historitë e... kur babai dhe axha Marko u zhdukën, ishin në një zyrë të shkollës së parë fillore në Ferizaj. Nuk e di si quhet kjo shkollë sot. Ndodhet në hyrje të qytetit, në hyrje të tregut, ajo rrugë.

...ata ishin brenda asaj shkolle. Rreth orës 1:00 pasdite. Profesorët dhe të gjithë nxënësit ishin aty, orët po zhvilloheshin, ushtarët e KFOR-it ishin aty. Brenda zyrës ndodheshin tre kolegë të tyre, drejtori i shkollës, sekretari dhe besoj arkëtari. Emërtimet e punës së tyre nuk janë... E

sigurt jam për drejtorin dhe sekretarin, por për arkëtarin, nuk jam e sigurt nëse kjo ishte puna e tij në atë kohë. Ishin bashkë në zyrë dhe në deklaratën e parë fillimisht thuhej se kishin dalë për të pirë çaj në qytetin e Ferizajt dhe se nuk ishin kthyer më, dhe (një deklaratë tjetër thoshte) se dikush i kishte ftuar për shëtitje jashtë. Në fund, ata e pranuan, në mes të bisedës, se tre burra me uniforma të zeza kishin hyrë në atë vend. Nuk e treguan natyrën e shenjave në ato uniforma. (Gjithashtu thonë se) i pyetën se çfarë po bënin aty, por i morën dhe i çuan diku jashtë. Aty ndalet e gjithë historia.

(Ne kontaktuam) absolutisht të gjitha organizatat ekzistuese dhe personat që i njihnim personalisht. Prej UNMIK-ut te policia vendase, te KFOR-i, te Kryqi i Kuq Ndërkombëtar, te Kryqi i Kuq i Serbisë e deri te lidhjet personale me shqiptarët. Folëm edhe me fqinj të parë... Siç thashë, e lamë Ferizajn. Ia kemi ofruar shtëpinë dhe të gjithë pronën kujt do që ka ndonjë informacion. KFOR-i ofroi një shpërblim në vlerë prej 1000 dollarë për çdo informacion. E pyetëm çdo person që e njihnim personalisht dhe çdo organizatë, duke kërkuar çdo informacion për atë që u ndodhi atyre. U përfshinë edhe disa shqiptarë më në emër, sepse gjyshi im, **babai i babait dhe xhaxhait**, kishte shumë miq shqiptarë dhe prandaj i kontaktuam edhe këta njerëz. Megjithatë, askush nuk guxoi dhe nuk deshë ta thoshte të vërtetën.

Është shumë e pakuptimtë të flasësh për dikë nga familja sepse, thjesht, nuk mund të ketë fjalë të tjera përveç më të mirave. Përshkrimin më të mirë i babait tim, çfarë njeriu ishte, çfarë burri ishte, çfarë profesori, çfarë drejtori i institucionit, mund të merrni të gjitha përgjigjet nëse do të shkoni në qytetin e Ferizajt dhe pyesni për të. Do ta kuptoni vetë atë nëse e bëni këtë, sepse absolutisht ai ishte një person, pa përdorimin e asnjë fraze nga unë... ai nuk bënte dallime mes njerëzve, qofshin ato etnike, fetare, gjinore apo ndonjë dallim tjetër. Ai besonte te njerëzit deri në atë masë sa ju do të thonit se ishte shumë naiv. Thjesht, është sikur një person që u beson kaq shumë njerëzve nuk mund të kishte ekzistuar atëherë dhe sot. Mendoj se e gjithë kjo ndodhi sepse u besonte shumë njerëzve dhe prej këtu buron kjo padrejtësi.

Ishte plotësisht i përkushtuar ndaj punës së tij. Që nga lindja e diellit deri në perëndim, deri tek punëtori i fundit që dilte nga ndërtesa, ishte aty, duke punuar. Kishte kolegë, natyrisht, edhe serbë edhe shqiptarë, pa dallim... dhe po e përsëris, nëse do ta gjeni një bashkëbisedues që e njihnte babanë tim, do të mund ta krijoni vetë një ide se si ishte ai, një ide shumë më të mirë se ajo që mund ta them unë për babanë tim. sepse ashtu ishte.

Në atë kohë, isha më e madhja. (qesh) Ende jam më e madhja nga dy motrat më të vogla. Siç thashë, kam studiuar për drejtësi dhe shqetësimi im i vetëm ishte të përgatitesha për një provim, ta kaloja provimin. S'kisha tjetër, si ta thuash, barrë apo të merresha me gjëra të tjera përveç kësaj. Edukimi vinte i pari për babanë dhe nënën time dhe gjithashtu për vetë njerëzit që ishin me të në zyrë, fqinjët dhe këdo tjetër. Ndoshta do të mund të japin informacion më të detajuar dhe ta lavdërojnë babanë tim më shumë se vetë vajza e tij.

Drejtësia është një nocion që nuk mund ta definoj më. Deri para nja 10 vitesh, kam qenë me plot zemër dhe me gjithë fuqinë time duke investuar në atë fjalë "drejtësi". Kur rritesh... siç thashë, kurrë, as edhe një ditë të vetme, nuk e kam lënë Kosovën. Dhe teksa vëzhgoj diçka dhe dëgjoj,

ndjek ngjarjet, po filloj të dyshoj në këtë nocion dhe institutin e drejtësisë. Çfarë do të thotë në të vërtetë dhe si do të shfaqej drejtësia për mua?

Atë ditë, kur babai u zhduk, jeta e familjes sime dhe e imja ndryshoi krejtësisht. Jeta jonë do të ishte krejtësisht ndryshe nëse kjo nuk do të ndodhte. Po e them këtë sepse... do ta jap një shembull për ta përshkruar më lehtë. Besimi ynë, feja ortodokse, është plot festa. Jo vetëm festa ortodokse, por edhe të tjera, si nata e Vitit të Ri, kur të gjithë festojnë. Që atëherë, ne nuk i festojmë më ato festa, sepse shpirtat tanë nuk na lënë të festojmë.

Gjëja tjetër që do të përsëris është se ne, të krishterët ortodoksë, kemi një traditë ku ndezim qirinj në kishë. I ndezim për shëndetin e të gjallëve dhe i ndezim për paqen e të vdekurve, shpirtave. Shkojmë në kishë dhe nuk dimë ku ta ndezim qiririn. Të gjitha ditëlindjet, ne... si ta them këtë, e kemi krijuar disi një sistem për ta shmangur njëri-tjetrin në ditëlindje. Pra... më konkretisht, më s'kam besim se institucionet e Kosovës mund të na çojnë drejt drejtësisë. Fakti që unë ende jetoj në Kosovë dhe kam dy vajza, shpresoj se diçka do të ndryshojë në mënyrën se si e kuptojmë drejtësinë, veçanërisht këtu, në Kosovë, dhe si e kuptojmë atë që ka ndodhur realisht. Në këtë kuptim, nuk bëj dallime mes njerëzve, sepse çdo njeri bart dhimbjen e tij, por këtu po flas për babanë dhe familjen time. Ka ende këtë shpresë. Po zbehet nga dita në ditë, por nuk e lejoj që të zhduket plotësisht, sepse do të doja që edhe fëmijët e mi të vazhdojnë të jetojnë këtu. Marrë parasysh situatën e tanishme, nuk mund ta shoh një të ardhme për ne këtu. Ende po mbahem, por gjithashtu po pres me padurim ndryshimet.

Sigurisht, para së gjithash, është e rëndësishme ta gjejmë trupin. Nëse gjendet trupi, do ta zbulonim të vërtetën se çfarë saktësisht ka ndodhur. Ata që e kryen... është shumë e rëndësishme, ndoshta jo aq shumë për familjen tonë — sepse nëse do ta dëgjoja emrin e personit e dorasit, nuk do të kishte shumë rëndësi për mua — por thotë shumë për të ardhmen, për shoqërinë... nëse thirremi në demokraci dhe drejtësi dhe nëse ende duam të vazhdojmë t'i përdorim këto terma dhe nëse kemi ende të drejtën t'i shqiptojmë ato fjalë — atëherë po, emrat kanë rëndësi. Dhe pastaj, është e rëndësishme se kush e bëri atë. Se a do sjellë emri i tij ndonjë drejtësi, ju thashë, nuk e ndej këtë. Është e rëndësishme për mua ta gjej tani dhe të jem e sigurtë me ju, kjo është hera e parë që po përdor fjalën "trup" sepse nuk di si t'i shpreh mendimet e mia. Edhe pse kam qenë plotësisht e vetëdijshme për më shumë se 20 vjet, nuk mund të merrja kurrë guximin për ta thënë me zë të lartë se babi nuk është gjallë. Pra, mendoj se është e rëndësishme, mbi të gjitha, për këtë pjesë të territorit, për të zbuluar se kush ishin autorët, për të gjithë, nëse duam, e përsëris, nëse duam të vazhdojmë me zhvillimin dhe me një gojë plot demokraci dhe drejtësi. Pa të, gjërat nuk mund të shkojnë më larg.

Familjarët që nga fillimi janë përpjekur gjithmonë të organizojnë takime të përbashkëta dhe të krijojnë kontakte. Thjesht u përpoqëm ta ndajmë informacionin. Këto ishin, për fat të keq, lloji i informacionit si "Mua më ka thënë ai person se mund të jetë aty", dhe "mua më ka tha ai person se mund të jenë atje".

Në atë kohë, në fillim, ishte një hapësirë shumë e ngushtë për shkak të pamundësisë për të lëvizur. Tani, në këtë periudhë dhe për një periudhë të zgjatur, në masë të madhe jemi organizuar vetë dhe organizojmë takime, biseda dhe diskutime të rregullta, si me anëtarët e familjes nga komuniteti serb, të dashurit e të cilëve janë zhdukur, ashtu edhe me anëtarët e

komunitetit shqiptar. Ne i zhvillojmë këto aktivitete kryesisht përmes Qendrës Burimore (Personat e Zhdukur). E kanë një zyrë në Prishtinë.

Të gjithë anëtarët e familjeve që kanë dëshirë të marrin pjesë, mund të marrin pjesë në mbledhje dhe t'i ndajmë informacionet që kemi. Kjo na sjell... nuk mund të bëjmë shumë... si ta them. Çfarë mund të bëjmë tani është që bashkërisht të ndikojmë në të gjitha institucionet në zgjidhjen e çështjes së personave të pagjetur, në kuptimin që kjo është çështje politike tani dhe që ne, serbët dhe shqiptarët, familjarët, të mundohemi të ushtrojmë presion mbi Prishtinën dhe Beogradin. Nuk e di nëse jemi në gjendje ta bëjmë këtë sepse kjo është bërë për një kohë të gjatë. Dhe kur njerëzorja, çështja njerëzore kthehet në çështje politike, atëherë vijnë më shumë komplikime dhe zgjidhje më të vështira.

Ne nuk do të dorëzohemi. Ka disa familjarë që po plaken dhe nuk kanë më forcë apo janë të sëmurë. Shumë kanë vdekur. Thjesht, ka kaluar shumë kohë pa e ditur të vërtetën. Ne, brezat e rinj, po bëjmë çmos për të ushtruar atë presion dhe do të vazhdojmë ta bëjmë këtë. Pra, përgjigja është po — edhe bisedimet edhe takimet mbahen deri në masën e mundshme. Ne përpiqemi ta kuptojmë njëri-tjetrin, përpiqemi tërë kohën.

K2.0